



## Thirrje për aplikim për trajnerë në edukim

### Termet e referencës

Kjo thirrje është hapur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. Ajo bëhet për të siguruar trajnerë me eksperiencë në fushën e trajnimit të mësuesve në arsimin parauniversitar në kuadër të zbatimit të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve, 2024-2025.

Sigurimi i cilësisë në arsim dhe rritja e profesionalizimit të mësuesve udhëheqin gjithë angazhimin institucional të MAS-it në kuadër të prioritetëve të saj dhe përmbushjes së Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026. Ky program është shpallur për të përmirësuar standardet e mësimdhënies, për të mbështetur rritjen profesionale të mësuesve dhe për të siguruar arsim cilësor.

Qëllimi i programit kombëtar të zhvillimit profesional të mësuesve 2024-2025, është përmirësimi i rezultateve të të nxënitorëve të nxënësve përmes zhvillimit profesional të mësuesve, të koordinuar dhe të institucionalizuar me të gjithë aktorët në fushën e arsimit me fokus të lexuarit, matematikën, shkencat e natyrës (fizikë, biologji, kimi), aftësitë digjitale.

Tematikat e trajnimeve janë si më poshtë:

1. Trajnimi i mësuesve të lëndëve: *Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Shkenca (Fizikë, Biologji, Kimi)* për metodologjitë e mësimdhënies interaktive sipas qasjes STEM, në AMU dhe AML.
2. Trajnimi i mësuesve të arsimit fillor në lëndët: *Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre* për metodologjitë e mësimdhënies interaktive sipas qasjes STEM.
3. Trajnimi i mësuesve të lëndëve: *Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Shkenca (Fizikë, Biologji, Kimi)* për ngritjen e kapaciteteve për vlerësimet ndërkombëtare PISA, PIRLS, TIMSS, TALIS).
4. Trajnimi i mësuesve të arsimit fillor për përmirësimin e *aftësive së kodimit dhe të aftësive digjitale të nxënësve* në shkollat e pajisura me SmartLab.

## **Kualifikimi i kërkuar për kandidatët në këtë thirrje**

Aplikantët duhet të kenë kualifikimet e mëposhtme:

1. Formimi akademik në fushën përkatëse: *Gjuhë, Matematikë, Shkenca (Fizikë, Biologji, Kimi) dhe Teknologji.*
2. Përvojë e mirë në ofrimin e trajnimeve me cilësi të lartë (të paktën pesë vjet si trajner).
3. Përvojë pune në fushën e mësimdhënies (të paktën 5 vjet).
4. Botime të studimeve, artikujve, librave etj. në fushën përkatëse të edukimit.

### ***Kërkesa të tjera:***

1. Gatishmëri për të udhëtuar në qytete të ndryshme të Shqipërisë.
2. Gatishmëri për punë gjatë fundjavave.
3. Zotërim i aftësive për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë dhe platformave interaktive.
4. Aftësi të mira bashkëpunuese dhe komunikuese.

### **Trajnerët pritet të angazhohen dhe të kryejnë aktivitetet e mëposhtme:**

1. Të bashkëpunojnë me institucionet e arsimit të lartë që do të udhëheqin procesin e trajnimeve të mësuesve.
2. Të paraqesin një plan pune për zhvillimin e trajnimit bazuar në modulën dhe udhëzimet e dhëna nga MAS dhe ASCAP, duke përfshirë agjendën, kalendarin dhe metodologjitë e trajnimit si dhe treguesit e cilësisë së trajnimit.
3. Të hartojnë materiale që do të përdorin në trajnim: si prezantime inovatore apo tradicionale, fletë pune, pyetësorë, teste etj.
4. Të realizojnë seancat trajnuese në mënyrë cilësore dhe efektive.
5. Të përdorin platformat online për mbështetjen e trajnimit dhe procesit të mësimdhënie-nxënies.
6. Të mbështesin dhe të angazhojnë pjesëmarrësit gjatë trajnimit.
7. Të vlerësojnë pjesëmarrësit gjatë trajnimit dhe në përfundim të tij.
8. Të masin efektivitetin e trajnimit në përfundim të tij, sipas treguesve të cilësisë së trajnimit.
9. Të përgatisin raportin përfundimtar duke përfshirë problemet e identifikuara dhe sugjerimet për përmirësim, si më poshtë:

- informacion i përgjithshëm mbi modulin dhe procesin e trajnimit;
- ecuria e programit gjatë seancave të trajnimit;
- listprezencat dhe vlerësimin e pjesëmarrësve;
- rekomandime dhe sugjerime për përmirësim.

### Kriteret e Vlerësimit

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

Kriteri i vlerësimit	Pesha	Dokumentimi
Formimi akademik	20%	Kopje të diplomave dhe certifikatave.
Eksperiencia si trajner	50%	CV në të cilën evidentohet përvoja si trajner.  Referenca nga institucionet/organizata me të cilat është bashkëpunuar si trajner.
Përvojë pune në fushën e mësimitdhënies (të paktën 5 vjet)	20%	Vërtetim pune nga institucioni.
Botime të studimeve, artikujve, librave etj. në fushën përkatëse të edukimit	10%	Fotokopje të faqes së parë të botimit.

### Si të aplikoni

Paketa e aplikimit do të përfshijë sa vijon:

1. Formularin e aplikimit (bashkangjitur në aneks)
2. Diplomat dhe certifikatat
3. CV sipas formatit EUROPASS
4. Kontakte për referenca institucionet/organizata
5. Vërtetim pune nga institucioni
6. Fotokopje të faqes së parë të botimit



## **Dorëzimi i aplikimit**

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, në adresën Rr. Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë, Shqipëri, deri në datë 22.02.2024.

Aneks

Formati i aplikimit

Rubrika	Përshkrimi	Vite	Kontakte për referenca (në zërat ku është e aplikueshme)
<b>Emri, mbiemri</b>			
<b>Rezident në:</b>	(Qyteti)		
<b>Formimi akademik</b>	<i>Profili dhe titulli më i lartë akademik</i>		
<b>Eksperiencia si trajner</b>	<i>Përshkruaj shkurtimisht eksperiencat si trajner</i>		
<b>Përvojë pune në fushën e mësimdhënies (të paktën 5 vjet)</b>	<i>Përshkruaj shkurtimisht përvojën e punës</i>		
Botime të studimeve, artikujve, librave etj. në fushën përkatëse të edukimit	<i>Përshkruaj shkurtimisht botimet kryesore</i>		